

UDHËZIM
Nr. 42, datë 22.7.2014

PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE
TË KANDIDATËVE PËR PUNË

Mbështetur në shkronjën “c”, pika 1 e nenit 30 dhe shkronjën “f”, pika 1 e nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave mbi përpunimin e të dhënave personale gjatë fazës së rekrutimit të punonjësve në institucionet publike dhe private.

Neni 2

Mbledhja e të dhënave personale nga kandidatët për punë

1. Punëdhënësi mbledh të dhëna personale nga kandidatët vetëm kur qëllimi për të cilën do të përdoren ato është i ligjshëm.

2. Punëdhënësi mbledh të dhëna personale nga kandidatët vetëm aq sa i nevojiten dhe nuk tejkalon qëllimin e rekrutimit.

3. Kur punëdhënësi i kërkon kandidatëve për të plotësuar formularin e aplikimit si në format letër dhe në atë *online* në një faqe interneti, i informon kandidatët sipas kërkesave që parashikon ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet deklaratës së shkruar të politikave të privatësisë mbi rekrutimin.

Neni 3
Përkufizime

1. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Punëmarrës” dhe “punëdhënës” kanë të njëjtin kuptim me atë që përcakton Kodi i punës.

b) “Agjenci punësimi/agent” nënkuptohet institucion privat ose publik që ofron shërbime private ose shtetërore të punësimit dhe ndërmjetësimit.

Neni 4
Shpallja e vendeve të lira të punës

1. Kur punëdhënësi shpall një vend vakant punësimi në lajmërimet për vendet vakante që kërkon paraqitjen e të dhënave personale nga individët e interesuar, duhet të zbatojë kërkesat e nenit 2 të këtij udhëzimi.

2. Kur punëdhënësi shpall një vend vakant punësimi në lajmërimet për vendet vakante që kërkon paraqitjen e të dhënave personale të kandidatëve, së bashku me lajmërimin ai bashkëlidh ose publikon edhe deklaratën e shkruar të politikave të privatësisë mbi rekrutimin përveç nëse:

a) shpallja fton kandidatët për të plotësuar aplikimin e specifikuar nga punëdhënësi në të cilën përshkruhet dhe deklarata e shkruar e politikave të privatësisë;

b) shpallja identifikon shprehimisht personin e kontaktit nga i cili kandidatët mund të marrin një kopje të deklaratës së shkruar të politikave të privatësisë.

3. Kur punëdhënësi, drejtpërdrejt ose përmes agjentit,

shpall një vend vakant që kërkon paraqitjen e të dhënave personale të kandidatëve i ofron këtyre të fundit mjetet për të identifikuar punëdhënësin ose agjentin e tij.

4. Punëdhënësi nuk kërkon dorëzimin e të dhënave personale të individëve, kur nuk ka asnjë vend vakant punësimi, duke pasur si qëllim vetëm testimin e tregut të punës.

Neni 5
Agjencitë e punësimit

1. Kur punëdhënësi ngarkon një agjenci punësimi për të kërkuar ofrimin e të dhënave personale nga kandidatët dhe grumbullon të dhëna personale të këtyre kandidatëve, zbaton kërkesat e nenit 2 të këtij udhëzimi.

2. Kur punëdhënësi merr të dhëna personale nga kandidatët, drejtpërdrejt nga individët që kërkojnë mundësi punësimi, ose të ofruara nga agjencitë e punësimit rreth punë kërkuarve të tyre të regjistruar, ai:

a) përdor vetëm aq të dhëna sa i nevojiten për të vlerësuar përshtatshmërinë e individit për punësim; dhe

b) nuk i përdor këto të dhëna për asnjë qëllim tjetër përveç rastit kur individit ka dhënë pëlqimin e shprehur.

3. Kur punëdhënësi punëson një palë të tretë si një agjent të autorizuar për të vepruar për qëllime rekrutimi, punëdhënësi merr të gjitha masat që pala e tretë të mos i përdorë të dhënat për qëllime të tjera, të ndryshme nga qëllimi fillestar i përpunimit. Punëdhënësi lidh një kontratë të shkruar me palën e tretë në përputhje me udhëzimin nr. 19, datë 3.8.2012, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegim”, të miratuar nga Autoriteti i Komisionerit.

Neni 6
Regjistrimet e brendshme të kandidatëve për punë

1. Punëdhënësi mund të ripërdori të dhënat personale të kandidatëve për punë, të cilat janë mbledhur gjatë periudhës së rekrutimit vetëm nëse plotësohen të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) të përdorë të dhënat vetëm nëse kandidati ka dhënë pëlqimin me shkrim për përdorimin e të dhënave edhe për qëllime të tjera.

b) të hartojë politikën e privatësisë për të mbajtur të dhënat për këtë qëllim;

c) të përcaktojë periudhën kohore të ruajtjes së këtyre të dhënave;

ç) të marrë të gjitha masat për të siguruar që të dhënat mbahen të sigurta dhe aksesohen vetëm nga persona të autorizuar.

Neni 7
Përpunimi i të dhënave të kandidatëve

1. Punëdhënësi merr të gjitha masat organizative dhe teknike, për të siguruar, duke pasur parasysh natyrën konfidenciale të tyre, se të dhënat personale të kandidatëve për punë mbledhen, përpunohen dhe ruhen në mënyrë të sigurt, si në formatin elektronik, fotografik apo *hard copy*.

2. Punëdhënësi merr të gjitha masat organizative dhe teknike për të siguruar që stafi i autorizuar për të aksesuar të dhënat personale ka njohuritë e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Përveç se kur është përcaktuar ndryshe në ligj apo akte

nënligjore, punëdhënësi mbledh informacione shtesë rreth kandidatit për punë, për të plotësuar të dhënat e mbledhura nga aplikimi fillestar me qëllim vlerësimin e kandidatëve potencial për vendin vakant të punës duke siguruar që nuk mbledh më shumë të dhëna se sa i nevojiten për të përmbushur qëllimin.

Neni 8

Ruajtja e të dhënave

Të dhënat e dorëzuara për një aplikim pune duhet të ruhen vetëm për atë kohë sa e parashikon legjislacioni në fuqi.

Neni 9

Dispozitat e fundit

1. Janë përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi të gjithë kontrolluesit publik dhe privat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej Pogaçe

